

KONFERENCA E PARE E INFRASTRUKTURES SE CILESISE
19 MAJ 2009

SEKSIONI B2 - TEKNOLOGJI, LËNDË DRUSORE	
<i>Moderatorë - Alqi Çullaj, Kostandin Dollani</i>	
<i>Emrat e autorëve Titulli i referatit</i>	<i>Abstraktet</i>
<p>Spiro Drushku, Agim Malja, Ismet Beqiraj Kontrolli i cilësisë së hidrokarbureve që tregtohen në vendin tonë.</p>	<p><i>Abstrakt:</i> Nisur nga ritmet e zhvillimit të këtij sektori kyç të ekonomisë, nevoja për konsum të nënprodukteve të naftës (karburante, lëndë djegëse dhe lubrifikante) nga viti në vit rritet me $15 \div 20\%$. Mbështetur në strukturën ekzistuese të mjeteve të transportit, konsumi i karburantit diezel është akoma mbizotërues dhe zë rreth 80% te nevojave për karburant në këtë sektor . Gjithashtu për nevoja energjetike komunale dhe rezidenciale po zhvillohet me ritme të shpejta edhe tregu i Gazit të Lëngshëm të Naftës . Përparësi po merr edhe tregu i lëndës djegëse të lëngët (solari) për nevoja industriale dhe prodhimin bujqësor me sera . Rritja e konsumit të nënprodukteve të naftës, si domosdoshmëri e rritjes ekonomike, ka nxjerrë në pah problemet ambientale dhe të ndotjes së mjedisit . Kjo situatë ka nxjerrë në evidencë jo vetëm monitorimin e treguesve cilësorë por edhe përmirësimin e cilësisë së nënprodukteve të naftës me kah drejt standardeve të BE-së. Objekt i këtij punimi ka qenë monitorimi disavjeçar i cilësisë së karburanteve, lubrifikantëve dhe lëndëve djegëse të importuara dhe tregtuara në vendin tonë si dhe monitorimi disavjeçar i cilësisë së karburanteve, lubrifikantëve dhe lëndëve djegëse të prodhuara dhe tregtuara në vendin tonë.</p>
<p>Dritan Ajdinaj, Entela Lato, Hektor Thoma, Doklea Quku Vlerësimi i ngjitjes së materialeve veshës mbi pllakat e drurit.</p>	<p><i>Abstrakt:</i> Një studim u krye për vlerësimin e cilësisë së ngjitjes së veshjes që aplikohet nga industria jonë, krahasimin e cilësisë tonë me atë të importit, si dhe analizimin e ndikimit të temperaturës së presimit gjatë procesit të plastifikimit. Vlerësimi u bë me anë të matjeve laboratorike në laboratorin e studimit të drurit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, duke aplikuar standardin SSH EN 311. Kampionet konsistonin në pllaka të ndryshme druri të veshura me melaminë, rimeso dhe PVC. Gjatë testimeve u vu re se shkatërrimi i mostrave nuk ndodhte në shtresën ngjitëse midis materialit veshës dhe pllakës, por në faqen e jashtme të saj. Kufiri minimal i fortësisë së ngjitjes së rimesos me trashësi 0.6 mm mbi pllakën MDF rezultoi 1.63 N/mm², ndërsa ai i fortësisë së ngjitjes së melaminës mbi PZ për kompanitë tona rezultoi 1.72 N/mm², 0.02 N/mm² me i lartë se ai i pllakave të importit (1.697 N/mm²).</p>

KONFERENCA E PARE E INFRASTRUKTURES SE CILESISE

19 MAJ 2009

<p>Arben Bejtja, Pandeli Marku</p> <p>Një vështrim mbi perceptimin e cilësisë në industrinë e përpunimit të drurit në Shqipëri.</p>	<p><i>Abstrakt: Departamenti i Industrisë së Drurit, pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore në Universitetin Bujqësor të Tiranës nga viti 2006 ka filluar një studim lidhur me zhvillimin e industrisë së drurit në Shqipëri. Studimi është shtrirë në organizata të regjistruara në drejtoritë e tatim-taksave si « subjekt i madh » dhe është në vazhdim. Pjesë e studimit është dhe një pyetësor i hartuar nga specialistë të fushës së përpunimit të drurit dhe të ekonomisë.</i></p> <p><i>Nga çështjet pjesë të pyetësorit janë dhe ato lidhur me menaxhimin e cilësisë, mënyrat e kontrollit, certifikimin etj. ,të shoqëruara me pyetje si A jeni të interesuar për certifikimin e produktit? Nëse po, çfarë përfitimesh prisni ju nga ky proces ? Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se mjaft organizata nuk kanë informacionin e duhur për certifikimin, përparësitë e tij, rrugët për ta realizuar etj. Po kështu ka dhe organizata që nuk kanë njohuri për institucionet si DPA, DPM, DPS.</i></p>
<p>Gani Pllana</p> <p>Rëndësia e konstruktimit me kompjuter gjatë zhvillimit të produktit industrial.</p>	<p><i>Abstrakt: Brenda konstruktimit me kompjuter qëndron një potencial tjetër enorm për kursimin e kohës dhe të shpenzimeve lidhur me shfrytëzimin dhe manipulimin më efikas të konstruksioneve ekzistuese. Kjo ka të bëjë si me ndryshimet të cilat janë të nevojshme në një konstruksion gjatë rrjedhës së zhvillimit të produktit, ashtu edhe me shfrytëzimin e konstruksioneve themelore të njohura dhe të verifikuara.</i></p> <p><i>Konstruksioni përkundër përkrahjes nga CAD-i nuk ofron sot drejtpërdrejt një rezultat i cili është optimal i arsyeshem në lidhje me kërkesat shpesh kundërthënëse siç janë efektiviteti, besnikëria, cilësia, qëndrueshmëria, pamja, shpenzimet, prodhueshmëria, etj. Megjithatë, qëllimi është që modeli i krijuar tanimë në kompjuter, të lirohet nga mangësitë dhe eventualisht të përmirësohet. Kjo realizohet përmes programeve përkatëse të analizës dhe simulimit.</i></p> <p><i>Fjalët kyçe: Konstruktimi me kompjuter, cilësia e produktit, ekonomiciteti, CAD, CAE.</i></p>
<p>Bujar Sciti, Dritan Topi</p> <p>Cilësia e përbërjes dhe menaxhimi i sigurisë në përdorimin gazit natyror të lëngëzuar.</p>	<p><i>Abstrakt: Harmonizimi i politikave të rritjes ekonomike me kërkesat e standarteve cilësore të sigurisë dhe atyre mjedisore, përbëjnë një drejtim të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit. Tregu i vendit tonë është ende defiqitar në furnizimin me burime energjetike, ku peshën kryesore e kanë nënproduktet e naftës (afro 62% të bilancit energjetik kombëtar). Në këtë aspekt për diversifikimin e burimeve energjetike është e nevojshme lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit natyror. Në këtë punim po paraqesim në mënyrë sintetike disa aspekte mbi mundësinë e futjes në tregun e vendit tonë të Gazit Natyror të Lëngëzuar (G.N.L.), duke trajtuar veçanërisht standardet e cilësisë të këtij produkti, si edhe standardet e sigurisë të cilat lidhen me terminalët, impiantet dhe pajisjet që operojnë me G.N.L si dhe menaxhimi i riskut.</i></p> <p><i>Në material trajtohen rregulloret, kodet dhe standardet që aplikohen për këtë qëllim në vendet e Bashkimit Evropian (të tilla si EN), në SHBA (NFPA, API, SPI, ASME, ASTM), si dhe standarde të tjera ndërkombëtare, të tilla si: IEC, ISA, OCIMF, SIGTTO dhe ISO, etj.</i></p> <p><i>Fjalë Kyçe: Gazi Natyror i Lëngëzuar, siguria e G.N.L., përbërja e G.N.L., lëngëzimi, Transporti, rigazifikimi.</i></p>

KONFERENCA E PARE E INFRASTRUKTURES SE CILESISE
19 MAJ 2009

<p>Doklea Quku, Entela Lato, Holta Çota Ndikimi i defekteve të drurit të ahut (Fagus sylvatica) në cilësinë e prodhimit të lëndës së sharruar.</p>	<p><i>Abstrakt: Trupat e ahut zënë rreth 72 (%) të lëndës së punimit që prodhon sektori ynë pyjor. Kjo lëndë e parë, si material biologjik është e prekur nga mjaft defekte të natyrës morfologjike, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi rendimentin cilësor të prodhimit të lëndës së sharruar.</i></p> <p><i>Një studim u krye mbi ndikimin e defekteve të drurit të ahut në klasifikimin cilësor të lëndës së sharruar, duke përdorur si sisteme klasifikimi standardet europiane (Standardi European EN 1316 -1 i adaptuar si standart shqiptar në vitin 2003) dhe ato shqiptare (Trupa nga lënda e drurit për lëndë të sharruar, traversa kompesato e rimeso SSH 736-88).</i></p> <p><i>U morën në shqyrtim tre kompani: “Ardeno”, “Sinani” dhe “Sanida”, të cilat si pjesë të aktivitetit të tyre kanë edhe prodhimin e lëndës së sharruar, kryesisht të llojit ah. Për secilën prej tyre u mor një provë prej 30 trupash dhe pasi u bë ndarja e tyre në klasa cilësie sipas Standardit EN dhe SSH, i cili aplikohet pjesërisht nga kompanite tona.</i></p> <p><i>Rezultatet treguan se sipas Standardit EN në klasën F-A u klasifikuan vetëm 1% e trupave të përdorur; në klasën F-B u klasifikuan mesatarisht 23 % e trupave; në klasën F-C u klasifikuan mesatarisht 70% e trupave dhe në klasën F-D u klasifikuan mesatarisht 6 % e trupave. Ndërsa klasifikimi sipas standartit shqiptar që njeh tre klasa cilësie, rezultuan: Cilësi I 7%, Cilësi e II 30% dhe Cilësia e III 63%.</i></p> <p><i>Rezultatet e studimit treguan që klasifikimi sipas standartit European bën një zhvlerësim cilësor të trupave të sharrës duke e krahasuar me atë shqiptar. Kjo paraqet një situatë problematike, lidhur me varfërimin e tregut me trupa cilësore, aktualitet jo vetëm për vendin tonë por edhe për vende të tjera me një sektor pyjor shumë më të zhvilluar se i joni.</i></p> <p><i>Nga rezultatet del se trajtimet silvoteknike në pyll, përbëjnë një mundësi objektive për përmirësimin cilësor të trupave.</i></p>
<p>Liljana Kola Gjurmuesit Fluoreshentë dhe Vlefshmëria e Matjeve me Instrumentin LS 55.</p>	<p><i>Abstrakt: Metoda e gjurmuesve artificialë dhe përdorimi i teknikës spektrofluorometrike luan një rol të rëndësishëm në studimin e mjediseve ujore. Ajo konsiston në injektimin në sistem të një gjurmuesi, që mund të identifikohet e matet në pika të tjera të sistemit. Matjet e komponimeve fluoreshente në mostrat ujore të kampionuara në të gjithë pikat e kampionimit në zonën e studimit, janë kryer me Spektrometrin e Luminishencës Perkin Elmer LS 55, me metodat sinkron – skan dhe të koncentrimin të krijuara për secilën prej tyre me parametrat përkatës. Administrimi i sistemit dhe i matjeve e rezultateve të tyre bëhet nëpërmjet softit FL WinLab. Ky punim paraqet eksperiencën e QFBZ, Tiranë, për vlerësimin e vlefshmërisë së matjeve me instrumentin LS 55, studimin e stabilitetit të tij, ndjeshmërisë etj. për të qënë më të sigurt për saktësinë e matjeve. Po ashtu paraqiten edhe eksperimente që provojnë që spektrofluorometri LS 55 garanton matjen e komponimeve fluoreshente në mostrat ujore në nivele gjurmë, të rendit 10^{-12}</i></p>

KONFERENCA E PARE E INFRASTRUKTURES SE CILESISE 19 MAJ 2009

<p>Neda Koçi, Bexhet Kamo, Argenti Lala Cilësia dhe problemet teknike gjatë matjeve të niveleve të fushës elektromagnetike në afërsi të antenave celulare.</p>	<p>Abstrakt: Progresi i vazhdueshëm i teknologjisë ka sjellë një përdorim gjithmonë e më të gjere të pajisjeve pa tela, si pasojë ekspozimi i njeriut kundrejt fushave elektromagnetike me frekuencë të lartë është në rritje. Matja dhe raportimi i niveleve të rrezatimit të fushave elektromagnetike është i detyrueshëm në shumë vende të botës me anë të kuadrit ligjor, si dhe rregulloreve dhe specifikave të vendosura nga standarte kombëtare dhe ndërkombëtare. Disa nga këto standarte vendosin gjithashtu kriterin e kryerjes së matjeve nën kontrollin e një sistemi cilësie, siç janë ato të përcaktuara nga udhëzimi ISO/IEC 17025. Ky punim do të adresojë zbatimin e kriterëve teknike dhe cilësore të detyruara nga ISO/IEC 17025 në një laborator për matjen e niveleve të fushës elektromagnetike të rrezatuar nga transmetimet në radio-frekuencë (RF) në mjedisin rrethues.</p>
<p>Kostandin Dollani, Nikolla Civici, Ervis Telhaj, Leon Këllezi Përcaktimi i Etalonit Kombëtar për rrezatimet jonizuese.</p>	<p>Abstrakt: Në materialin e paraqitur përshkruhen veprimet e ndërmarra për realizimin dhe mbajtjen e një etaloni në fushën e metrologjisë së rrezatimeve jonizuese në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar. Pas përdorimit disa vjeçar në këtë institucion të dy burimeve radioaktive etalone, në vitin 2004 u ngrit Laboratori Dozimetric Standard Dytësor, në pajisjet e të cilit bëjnë pjesë një burim radioaktiv Cs-137 me aktivitet 740 GBq, një makinë e rrezeve X dhe dy dhoma jonizimi së bashku me elektrometrat, të kalibruar sipas parimit të ruajtjes së aftësisë gjurmuese në laboratorë kalibrues parësorë. Qendra merr pjesë në veprimtari ndërkrahasuese në fushën e dozimetrisë së rrezatimeve jonizuese të organizuara nga organizata të specializuara ndërkombëtare ku ka arritur rezultate të kënaqshme si dhe kryen kalibrimin e dozimetrave personale dhe të aparateve dozimetrike.</p>
<p>Ismet Beqiraj, Spiro Drushku Mundësi teknologjike për përmirësimin e karburantit Diesel të prodhuar në KPTHN, Ballsh.</p>	<p>Abstrakt: Pas viteve '90 sektori i transportit në vendin tonë mori një zhvillim me ritme shume të shpejta dhe sipas të dhënave të INSTAT-it deri në fund të vitit 2001 numri i automjeteve të transportit rrugor arriti në 214505, nga këto 133288 autovetura . Automjetet diesel zënë rreth 75-80 % të numrit të përgjithshëm të tyre. Mbështetur në këtë strukturë të mjeteve të transportit, konsumi i karburantit diesel është akoma dominant dhe zë mbi 80% të nevojave për karburant në këtë sektor. Kjo situatë nxjerr në evidence monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së karburantit diesel, sidomos atij të prodhuar në vend me kah drejt standardit eurodiesel.</p> <p>Ky studim kontribuon në përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së dieselit, sepse karburantet me përmbajtje të lartë sqfuri gjatë djegies ndotin ajrin e mjediseve tona urbane. Materiali trajton monitorimin njëvjeçar të cilësisë së karburanteve të prodhuara në KPTHN dhe të faktorëve që ndikojnë në proceset e hidropastrimit të karburanteve në kushtet industriale. Në material jepen të përmbledhura rezultatet përfaqësuese, të kontrollit të prodhimit industrial në Kombinat nga Janari 2006 deri në Shkurt 2007, për rreth 1300 mostra gazoli, të realizuara në 220 ditë pune teknologjike të rafinerisë.</p>

KONFERENCA E PARE E INFRASTRUKTURES SE CILESISE
19 MAJ 2009

<p>Nikolla Civici Sigurimi dhe kontrolli i cilësisë së rezultateve gjatë analizës elementore të mostrave gjeologjike me metodën e spektrometrisë së fluoreshencës së rrezatimit X.</p>	<p><i>Abstrakt: Një nga aktivitetet më të rëndësishme të punës në laboratorin e Spektrometrisë së Fluoreshencës së Rrezatimit X (SFRX) të Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar është hartimi i procedurave analitike që sigurojnë marrjen e rezultateve në përputhje me cilësinë e kërkuar nga përdoruesit. Puna për hartimin e këtyre procedurave, që mbulojnë të gjitha etapat (optimizmin e pajisjes matëse, kalibrimin, procesin e matjes, vlerësimin e limiteve të detektimit, precizionit, saktësisë dhe validimit të rezultateve), merr një rëndësi të veçantë për arsye se ekzistojnë pak raste kur përdorimi i metodës SFRX është standardizuar nga trupa ndërkombëtare. Në këtë punim do të paraqesim hapat e ndjekura për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë së rezultateve gjatë analizës së mostrave gjeologjike, gjatë punës për hartimin e atlasit gjeokimik të Shqipërisë i cili është mbështetur mbi rezultatet e marra nga analiza shumë elementare (25 elementë) e rreth 1300 mostrave të dherave dhe sedimenteve të mbledhura në territorin e vendit me anë të metodës SFRX.</i></p>
<p>Adelina Skënderi, Elmaz Shehu, Ali Gjebrea, Armand Çomo Kontrolli i proceseve në industrinë e përpunimit të lëkurëve në përfitim të produktit të pastër.</p>	<p><i>Abstrakt: Materiali i paraqitur është një përpjekje për të pakësuar impaktin negative në mjedis të procesit të përpunimit të lëkurëve nëpërmjet përmirësimit të proceseve dhe përdorimit të kontrolluar të kimikateve për të përfutur kështu produktin e pastër që do të thotë pakësimi i ndotjes në burim. Teknologjia e përpunimit të lëkurëve është komplekse dhe përbëhet nga një sërë procesesh. Në këto procese veç lëndëve të para që do të përpunohen, përfshihen edhe shumë kimikate. U monitoruan kloruret, pH, NH₃, sulfuret, NKO, NBO₅, kromi total dhe lëndët e patretura. U aplikua riciklimi i NaCl në procesin e njomjes dhe pas disa ndërhyrjeve të bëra rezultoj se nivelet shkarkimeve u afruan me normat e lejuara. Këto ndërhyrje patën impakt pozitiv edhe në bilancin ekonomik. Pas aplikimeve të reja karakteristikat e lëkures janë po ato të përfutuara me metodat konvecionale.</i></p>
<p>Osman Muftić, Fikret Veljović, Tanja Jurčević Lulić, Gani Pllana Vlerësimi hipotetik i ndikimit të majmërisë së trupit të njeriut në aftësinë për punë.</p>	<p><i>Abstrakt: Në këtë punim është dhënë një pamje e shkurtër për mundësinë e vërtetimit të presionit në hapësirën e abdomenit. Pastaj është fut emërtimi para presion për abdomenin e shtypur dhe për pozicionin me trup të kërrusur përpara, dhe atë për subjekte referente (meshkuj dhe femra). Për subjekte të zgjedhura të tilla, janë shtuar në masën trupore, masat në shkallë prej nga 10 kg dhe janë përlogaritur momentet përkatëse në kuadër të aksit të rrotullimit (aksi i cili kalon nëpër kokëzat e ashtit të kërdhokullës me supozim se dimensionet antropometrike nuk ndryshojnë, e gjithashtu edhe krahët e forcave në subjektet referente). Siç shihet, rritja e presionit në shembullin ekstrem (për masën prej 150 kg), rezultojnë pa kurrfarë ngarkese të jashtme edhe deri në 300% ndaj vlerës fillestare.</i></p>